



MARREVESHJE BASHKËPUNIMI

Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë me seli në Prishtinë, Republika e Kosovës, i përfaqësuar nga Prof. dr. Teuta Shala-Peli

&

Qendra për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave të Malit të Zi me seli në Podgoricë, Republika e Malit të Zi, i përfaqësuar nga Gzim Hajdinaga.

Neni 1 - Qëllimi

Duke e parë nevojën për bashkëpunim të përbashkët kulturor dhe mbështetje reciproke insitucionale në fushat prioritare të dy institucioneve, si dhe duke marrë parasysh rëndësinë dhe rolin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore e historike, si dhe bashkëpunimin shkencor në këtë fushë, "Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë" dhe "Qendra për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Kulturës së Pakicave të Malit të Zi" u dakorduan për firmosjen e marrëveshjes së bashkëpunimit.

Neni 2 - Objekti i marrëveshjes

Duke u nisur nga fakti se bashkëpunimi i ndërsjellë dhe reciprok midis dy institucioneve paraqet prioritet të rëndësishëm në aktivitetet e tyre, të njëjtët vendosën se objekt i kësaj marrëveshjeje janë këto elemente kyçe:

- Këmbimi i literaturës profesionale – shkencore për nevojat e institucioneve respektive, bibliotekave dhe shkollave;
- Realizimi i projekteve kulturore-shkencore në fushën e historisë dhe trashëgimisë kulturore;
- Këmbimi i kontakteve dhe bashkëpunimit me qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar të të dy institucioneve;
- Ndihmë reciproke në realizimin e projekteve kulturore-shkencore;
- Botimi i veprave me interes të përbashkët;
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta me tematikë të trashëgimisë kulturore dhe historike.
- Prezantimi-ekspozita të trashëgimisë kulturore;



Neni 3 - Literatura profesionale

3.1. Dy institucionet kanë nevojë për përforcimin e bashkëpunimit, mbështetjes dhe ndihmesës së ndërsjellë në këmbimin e literaturës profesionale dhe revistave shkencore që do të jenë me interes të dy institucioneve, bibliotekave dhe shkollave në shtetet respektive.

3.2. Për këtë qëllim institucionet u dakorduan që të zhvillojnë sistem me të cilin do të përforcohet bashkëpunimi dhe komunikimi midis bibliotekave të institucioneve, që do të mundësojë qasje pa pengesa në fondet bibliotekare.

Neni 4 - Projekte dhe hulumtime

4.1 Dy institucionet kanë nevojë për bashkëpunim në realizimin e projekteve të përbashkëta për të cilat ka interes reciprok, sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje.

4.2 Dy institucionet u pajtuan që të formohen grupe që do të përgatisin elaborate për projektet tëpërbashkëta.

Drejtor i Qendres për Ruajtjen
dhe zhvillimin e kulturës së
pakicave të Malit të Zi.

z. Gzim Hajdinaga

Instituti i Historisë "Ali Hadrić" Prishtinë



Prof. dr. Teuta Shala - Peli